




Planuar / Doretuar Pritimjen/Produkt Received/Delivered	28.05.2021	viti god year	1
Organ /Njesia Organ /Jedrnica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHICK	2709/2021		113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.277/2021

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-Kryetare e Kolegjit, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.277/2021 të datës 15.04.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga „7 marsi“, nr.22, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “kompenzim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 26.05.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.277/2021 të datës 15.04.2021, të parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi i emëruar sipas vendimit me numër 01nr.112-1134 të datës 18.09.2018, në pozitën “Drejtor i Teatrit të Qytetit -Dodona” në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, të Komunës së Prishtinës, me datën 12.03.2021, ka parashtruar kërkesë në Komunën e Prishtinës për pagesë të shtesës për shërbyes civil (shck-në) në vlerën prej 31.20 euro.

I pakënaqur me mos nxjerrjen e vendimit nga ana e Komunës së Prishtinës, lidhur me realizimin e shtesës për shërbyes civil, ankuesi me datën 15.04.2021, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 1797/2021 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për realizimin e shtesës për shërbyes civil në vlerën prej 31.20 euro si dhe kompensimi retroaktiv për këtë shtesë për periudhën e pa paguar kohore nga tetori i vitit 2018 e deri në shkurt të vitit 2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 15.04.2021 me Nr.Prot:1797/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt emërim i ankuesit me numër 01nr.112-1134 i



datës 19.09.2018; Kopje e ID-së së ankuesit; Kërkesë për pagesë të shtesës për shërbyes civil e datës 13.03.2021; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 12.03.2021; Vendim për emërimin e nëpunësit civil në pozitë të jo karrierës me numër 01nr.112-1134 i datës 18.09.2018.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, dhe pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se nuk i është bërë shtesa për shërbyes civil

në shumën prej 31.20 euro, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi  
*sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i referuar provave të lëndës, konstaton se ankuesi është në marrëdhënie punë në Komunën e Prishtinës respektivisht në Drejtorinë e Kulturës në pozitën "Drejtor i Teatrit të Qytetit -Dodona".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i referuar provave të lëndës, ka konstatuar se: sipas Ligjit, Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 2 paragrafit 4 përcaktohet se: *4. Nëpunës i Shërbimit Publik-është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike",* rrjedhimisht të punësuarit në fushën e kulturës në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë janë kategorizuar si nëpunës të shërbimit publik, andaj duke marrë parasysh se ankuesi tanimë me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i përket kategorisë së nëpunësve të *Shërbimit Publik*, Kolegji vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status të shërbimit publik.

Ndërlidhur me këtë pjesa V e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunësve të shërbimit publik, mbi këtë bazë dhe duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, sepse Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, atëherë udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike sipas nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente*


Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.




**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.277/2021**

**Ardita Perçuku-Shyti**

  
**Procesmbajtëse**

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

  
**Kryetare e Kolegjit**



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës të Prishtinës ;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Universitetin në Komunën Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

